



KTV  
Berat BICAJ  
Drejtësor  
Prishtinë

Ref:1912/1413/KPM/mf

**VENDIM**

**Lidhur me Ankesën nr. 2019/85-Familja Istogu.(Palë Ankuese) kundër KTV (“Palë Përgjegjëse”)**

**Faktet**

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës për Ofriuesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë KKPM-2016/3, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 30 shtator 2019, ka pranuar një ankesë nga Familja Istogu ndaj kronikës “Familja Istogu kërkon azil në Suedi për djalin e sëmurë” të transmetuar me datën 03 shtator 2019 në edicionin e lajmeve Interakiv të orës 19:00 në KTV. Pala Ankuese pretendon se me transmetimin e kësaj kronike: “Pala Përgjegjëse e ka bërë pa autorizim e familjes për çfarë kjo familje është ndier e thyer moralisht dhe psiqikishti si dhe i është shkelur privatësia, duke iu zbuluar të dhëna personale, gjendjen nëpër të cilën ka kaluar dhe është duke kaluar familja dhe se kronika e transmetuar në një televizion suedez, ka qenë e autorizuar nga familja e jo të shfaqet edhe në ndonjë medium tjetër”
3. KPM me datën 1 tetor 2019 përmes një shkresë e ka njoftuar Palën Përgjegjëse për ankesën e pranuar nga Pala Ankuese dhe ka kërkuar sqarim brenda tre (3) ditësh lidhur me pretendimet e ankesës.
4. KPM me datën 4 tetor 2019 ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse, duke pretenduar se kronika në fjalë është realizuar bazuar dhe përkthyer në materialin e televizionit suedez, STTV dhe se qëllimi i raportimit ka qenë i mirë me idenë që mund të ndihmojmë kauzën përvazhdimin e qëndrimit të foshnjës në Suedi për të marr trajtinin e duhur mjekësor. Ndërsa sa i përket materialit të transmetuar Pala Përgjegjëse thekson se nuk kanë hasur askund se ky material mund të transmetohet vetëm në Suedi. Po ashtu ka

shprehur keqardhje nëse me transmetimin e kësaj kronike mund të kenë shkaktuar shqetësim tek Pala Ankuese.

5. KPM ka analizuar ankesën e Palës Ankuese si dhe ka monitoruar kronikën e lartpërmendur dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 15 tetor 2019 ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.
6. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 29 tetor 2019 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.
7. KPM me datën 31 tetor 2019, ka pranuar edhe një përgjigje nga Pala Përgjegjëse, përmes të cilës e pranojnë se mund të kenë bërë shkelje të Kodit të Etikës, me përmendjen e emrit të sëmundjes së djalit të Palës Ankuese mirëpo pretendojnë se materialin e transmetuar e kanë marr nga televizioni suedez.

#### **Analiza Ligjore**

8. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse, është gjetur në shkelje të nenit 7, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Neni 7, paragrafi 1, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

*“E drejta e privatësisë së individëve duhet të respektohet. Ndërhyrja në çështjet thjeshtë private apo personale të cilat nuk kanë ndikim në interesin publik është e ndaluar. Ata që janë prekur nga tragjedia apo pikëllimi duhet të trajtohen me ndjeshmëri, respekt dhe maturi duke e respektuar privatësinë e plotë të tyre.”.*

9. KPM, me qëllim të vlerësimit të pretendimeve ankimore të Palës Ankuese ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse dhe në bazë të Raportit të monitorimit të kronikës së transmetuar ka gjetur se Pala Përgjegjëse me datën 3 shtator 2019 në edicionin e lajmeve Interaktiv të orës 19:00 ka transmetuar të dhëna të ndjeshme, përkatësisht të dhëna rrëth gjendjes shëndetësore djalit të Palës Ankuese në kronikën “Familja Istogu kërkon azil në Suedi për djalin e sëmurë” duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 1 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
10. KPM bazuar në të gjeturat e monitorimit, analizimin e ankesës së Palës Ankuese dhe përgjigjen e Palës Përgjegjëse, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, gjatë transmetimit të kronikës “Familja Istogu kërkon azil në Suedi për djalin e sëmurë”.
11. Komisioni duke u bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura, konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 7, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

## Vendimi

12. Komisioni kërkon nga Palën Përgjegjëse që në afat prej shtatë (7) ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, nëpërmes transmetimit t'i kërkojë falje Palës Ankuese për transmetimin e të dhënavë personale rreth gjendjes shëndetësore të djalit të tyre, ashtu siç përcaktohet me nenin 30, paragrafi 1, pika 2 të Ligjit të KPM-së.

## E drejta për Ankesë

13. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

14. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marries së vendimit të KPM-së; apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marries së vendimit.

  
Muja FERATI  
Kryetar

12.12.2019  
Datë

